



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim dhe krijimin e detyrueshëm të servitutit për interes publik, për pronat të cilat preken nga ndërtimi i Linjës së dyfishtë 110 kV Nën Stacioni Peja 3 dhe Peja 1 dhe Rehabilitimi i Linjës ekzistuese 110 kV Nën Stacioni Peja 2 dhe Nën Stacioni Deçan, Zonat Kadastrale: Ozhim, Vitomiricë, Treboviq, Pejë, Komuna Pejë dhe Zonat Kadastrale: Bellopojë, Veriq, Llukavc i Thatë, Gjurakovc, Prekallë, Dobrushë, Kashicë dhe Bajicë, Komuna Istog, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlerësimi i pronave do të kryhet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në Ministrinë e Financave, duke u bazuar në aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.
3. Obligohet Subjekti kërkuar, Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A) për pagimin e kompensimit të shpronësimit të pronave të paluajtshme dhe shpenzimeve të procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A).
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.02/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 39 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 100, 102, 103 dhe 108 të Ligjit Nr. 02/L-28 Për Procedurën Administrative, bazuar në Mendimin e Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit me nr. prot. 3659-2 datë 22.01.2016, në pajtim me nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Revokimin dhe Korrigjimin e pjesërishëm të Vendimeve Përfundimtare

1. Miratohet Revokimi i pjesërishëm i Vendimit Përfundimtar Nr. 03/30 datë 20.05.2015 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.13/05 Qershor 2015.
 - 1.1. Revokimi i pjesërishëm i Vendimit Përfundimtar nga pika 1. e këtij vendimi ka të bëjë me ndërprerjen e procedurës për shpronësimin e ngastrave kadastrale nr. 439-3, Zona Kadastrale Babush i Muhaxherëve dhe ngastrave kadastrale nr.303-0 dhe 673-0, Zona Kadastrale Marec, Komuna Lipjan, me titullarë, sipërfaqe dhe pozitë të përshkruar në numrin rendor 53, 66 dhe 90 në tabelat të cilat janë pjesë përbërëse e Vendimit Përfundimtar Nr. 03/30 datë 20.05.2015.
 - 1.2. Procedura e shpronësimit e ngastrave kadastrale të përshkruara në pikën 1.1 do të bëhet me Vendimin Përfundimtar për shpronësimet shtesë, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Sektori C1 dhe C2 sipas gjendjes faktike të ndarjeve teknike të ngastrave kadastrale të përshkruara në pikën 1.1 të këtij vendimi si dhe titullarëve përkatës të tyre.
2. Miratohet Korrigjimi i gabimit teknik në numra në Vendimin Përfundimtar Nr. 08/47 datë 02.09.2015 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.30/25 Shtator 2015, kështu që sipërfaqja në parcelën nr.7586/3 Zona Kadastrale Prishtinë, në numrin rendor 4 të tabelës, si pjesë përbërëse e Vendimit të shënuar më lartë është përshkruar gabimisht numri (1142) në vend që të përshkruhet numri (1442) dhe te sipërfaqja mbetëse është përshkruar gabimisht numri (285) në vend që të përshkruhet numri (585).
 - 2.1. Sipas këtij Vendimi do të korrigjohet edhe tabela e Vendimit Nr.08/47 datë 02.09.2015 të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr.30/25 Shtator 2015.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/73


Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare për Kuvendin e Republikës së Kosovës për angazhimin e ekspertëve për studime rasti lidhur me përvojat ndërkombëtare, në rastet e ngjashme me Ndërmarrjen "TREPÇA", në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në buxhetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, kodi buxhetor 13440, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, në nënprogramin 10100 Anëtarët e Kuvendit.
3. Obligohet Ministra e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/73


Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit për vitet 2016 - 2020.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 142 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për Gjendjen e Natyrës për periudhën 2010-2014.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, mori:

V E N D I M

1. Arton Berisha, emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administratës Publike.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, mori:

V E N D I M

1. Xhelil Bekteshi, emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të Rregullores (QRK)- Nr.21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut (Komisioni)

1. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 1.1. Besim M. Kajtazi, ZKM, Kryetar;
 - 1.2. Arben Shamolli, MASHT, anëtar;
 - 1.3. Ivan Tomic, ZKM, anëtar dhe
 - 1.4. Fidan Kozhani, MASHT, anëtar;
2. Komisioni kryen detyra dhe përgjegjësitë në pajtim me Rregulloren (QRK) - Nr.21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/73


Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Integritit Evropian për t'i rekomanduar Presidentes së Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Integritit Evropian, për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. I Rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës të japë autorizimin për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.10/73

Datë: 05.02.2016

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 5 Shkurt 2016 mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shpronësimi i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të, cilat janë të nevojshme për realizimin e projektit me interes publik - ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Sektori C2b, Zonat Kadastrale Softaj, Pojatë, Talinoc i Muhaxherëve, Bibaj, Sojevë, Fshati i Vjetër, Komogllavë, Gërlicë dhe Rakaj, të Komunës së Ferizajit, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit Nr. Protokolli 95/16/1/2/3/4/5/6/7/8 datë 13.01.2016 në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 6390/15 datë 18.12.2015 dhe Nr.32/16 datë 08.01.2016.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ibrahim Makolli, emërohet Kryetar i Delegacionit të Kosovës për bisedime për çështjen e personave të zhdukur, në kuadër të Grupit Punues për Persona të Zhdukur në mes të Prishtinës dhe Beogradit, nën kryesimin/ndërmjetësimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.
2. Kryetari i Delegacionit, pas konsultimeve me Kabinetin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës do të njoftojë Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, si Kryesues i Grupit Punues për Persona të Zhdukur, mbi përbërjen e Delegacionit.
3. Kryetari i Delegacionit, pas konsultimeve me Kabinetin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe anëtarët e Delegacionit, do të caktojë përfaqësuesit e Delegacionit të Kosovës në aktivitetet zyrtare dhe Nëngrupet Punuese në kuadër të Grupit Punues për Persona të Zhdukur.
4. Kryetari i Delegacionit, apo anëtari i Delegacionit i autorizuar nga Kryetari i Delegacionit, i komunikon palëve të interesit dhe medieve mbi zhvillimet e procesit dialogues për çështjen e personave të zhdukur.
5. Kryetari i Delegacionit njofton Kryeministrin e Republikës së Kosovës me raporte të rregullta mbi procesin dialogues për çështjen e personave të zhdukur.
6. Paga e Kryetarit të Delegacionit do të jete e barabartë me pagën e Zëvendësministrit.
7. Njësia e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ofron shërbimet e nevojshme të sekretarisë për mbarëvajtjen e punës së Delegacionit.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/73

Datë: 05.02.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, sipas Nenit 5 të Rregullores (QRK) - Nr.21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, përbëhet prej katër (4) anëtarëve, si në vijim:
 - 1.1. Dy (2) anëtarë të propozuar nga Kryeministri, dhe
 - 1.2. Dy (2) anëtarë të propozuar nga Ministri i MASHT-it.
2. Obligohet Zyra Ligjore, në Zyrën e Kryeministrit, që ndryshimet e përcaktuara në pikën një (1) të këtij vendimi, t'i përfshijë në Rregulloren (QRK) - Nr. 21/2015.
3. Obligohen të gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores (QRK) - Nr. 21/2015 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/73

Datë: 05.02.2016

Në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, nenit 108 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, të nenit 18, paragrafi 1.6. të Rregullores nr 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nenit 4 paragrafi 2.1 të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2016 Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për Korrigjimin e Vendimit Nr. 08/44 të datës 12.08.2015 për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10.
2. Korrigjimi sipas pikës 1. ka të bëjë me përmirësimin e gabimit teknik në pikën 1. të Vendimit Nr. 08/44 të datës 12.08.2015, kështu që pas fjalëve "Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim" shtohen fjalët "dhe Bankën Evropiane të Investimeve".
3. Ky Vendim paraqet pjesë përbërëse të Vendimit Nr. 08/44 të datës 12.08.2015, dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të korrigjuar sipas këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë